



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNITETI
REPUBLIC OF KOSOVO
OPSHTINA LIPJAN

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Lipjanit

Pranuar me:
Primiçeno:

20.01 2026

Opshina Lipjan/Municipality of Lipjan

Njësia
Jednica:

Shërbimet
Dodatak

Imri Ahmeti

01-306/01-3252



Raporti për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Lipjanit për periudhën janar-dhjetor 2025

Janar, 2026

Hyrie

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Lipjanit ka për qëllim vazhdimin e transformimit të komunës në një rajon me rritje të qëndrueshme dhe të balancuar ekonomike. Kjo përfshin përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e sektoreve kryesore përmes pesë objektivave kryesore.

1. Objektivat kryesore

1. **Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe punësimi:** Strategjia synon nxitjen e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës duke përfshirë sektorë kyç si industria, tregtia, bujqësia, dhe sektorët me investime të larta, duke ulur papunësinë dhe rritur punësimin gjithëpërfshirës.
2. **Zhvillimi i arsimit:** Synohet përmirësimi i cilësisë së arsimit për të gjithë qytetarët përmes ndërtimit dhe rinovimit të infrastrukturës arsimore, ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe gjithëpërfshirjes.
3. **Përmirësimi i infrastrukturës publike:** Ky objektiv përfshin përmirësimin e rrjetit rrugor, ndriçimit publik, si dhe zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe të jetesës për qytetarët e komunës.
4. **Zhvillimi rural dhe bujqësor:** Fokusi është në rritjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin e infrastrukturës për përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale.
5. **Turizmi, trashëgimia kulturore dhe mbrojtja e mjedisit:** Strategjia përfshin ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe zhvillimin e turizmit dhe infrastrukturës rekreative dhe sportive, për të tërhequr më shumë vizitorë dhe për të forcuar identitetin kulturor të komunës.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Lipjanit është ndërtuar mbi një qasje metodologjike të mirëstudiuar, e cila përfshin analiza të thella dhe konsultime me aktorë kryesorë lokalë. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota nga regjistrimi i fundit, janë zhvilluar intervista dhe diskutime me drejtues të komunës dhe sektorë të ndryshëm për të krijuar një pasqyrë reale të gjendjes ekonomike dhe sociale. Ky proces siguroi që strategjia të bazohet në informacion të besueshëm dhe të jetë e informuar nga një gamë e gjerë perspektivash.

2. Monitorimi dhe raportimi

Për vitin 2025, në planin e veprimit të strategjisë janë planifikuar gjithsej **41 aktivitete**. Në përputhje me mandatin ligjor dhe planin vjetor të punës për vitin 2025, komuna e Lipjanit ka përgatitur dhe hartuar një raport gjithëpërfshirës për zbatimin e këtij plani të veprimit.

Raporti ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në procesin e zbatimit të aktiviteteve, duke përfshirë veprimet e ndërmarta nga të gjitha njësitë administrative të komunës. Zbatimi i strategjisë është monitoruar nga komisioni i përzgjedhur, i cili ka mbledhur dhe analizuar të dhënat nga drejtoritë dhe sektorët përkatës.

Ky raport mbulon periudhën janar – dhjetor 2025 dhe ofron një pasqyrë të përmblendhur dhe të qartë të nivelit të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara.

3. Metodologjia e përdorur


Për mbledhjen e informacioneve, secili anëtar i komisionit ka bashkëpunuar ngushtë me drejtorinë përkatëse, me qëllim të verifikimit të nivelit të përmbushjes dhe zbatimit të aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit të strategjisë. Gjatë këtij procesi janë analizuar aktivitetet e realizuara dhe afatet kohore. Në bazë të informacioneve të mbledhura nga drejtoritë përkatëse, është hartuar raporti përkatës, ndërsa të dhënat janë sistemuar dhe paraqitur në mënyrë të përmblendhur në tabelën e mëposhtme, duke ofruar një pasqyrë të qartë të progresit të arritur.

4. Të gjeturat

Nga analiza e të dhënave të mbledhura mbledhura mbi zbatimin e planit të veprimit të SZHLE-së për periudhën janar – dhjetor 2025 rezulton se nga gjithsej **41 aktivitete të planifikuara, 41 janë realizuar, duke dëshmuar për nivel të lartë të zbatueshmërisë së planit të veprimit**.

Megjithatë, 2 nga këto aktivitete nuk janë realizuar plotësisht, pasi janë të planifikuara për më shumë se dy vite dhe janë realizuar vetëm pjesërisht, duke qenë se kanë filluar gjatë periudhës raportuese dhe vazhdojnë të zbatohen sipas planifikimit të paraparë.

Më poshtë është paraqitur tabela që tregon realizimin e planit të veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për vitin 2025.



Tabala 1. Realizimi i planit të veprimit për vitin 2025

5. Rekomandimet

Për të siguruar zbatimin e plotë të planit të veprimit, komuna e Lipjanit dhe menaxhmenti i saj duhet të demonstrojnë përkushtim të vazhdueshëm institucional në të gjitha drejtoritë. Kryetari i komunës duhet të sigurojë që secila drejtori të ndërmarrë masa konkrete për rritjen e nivelit të zbatimit të planit të veprimit. Po ashtu, të gjitha drejtoritë duhet të raportojnë në mënyrë periodike mbi progresin, sfidat dhe pengesat e hasura gjatë zbatimit të këtij plani:

1. Harmonizimi i planeve të veprimit me strategjinë për zhvillim ekonomik lokal. Secila drejtori duhet të planifikojë dhe zbatojë aktivitetet në përputhje të drejtpërdrejtë me objektivat e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

2. Zbatimi i aktiviteteve të papërbushura. Aktivitetet e papërfunduara, përfshirë ato të planifikuara për më shumë se një vit, duhet të vazhdojnë të monitorohen dhe të realizohen sipas afateve të përcaktuara.

3. Forcimi i monitorimit dhe mbikëqyrjes menaxheriale. Të forcohet roli i menaxhmentit komunal në ndjekjen e zbatimit të planit të veprimit përmes raportimit të rregullt dhe vlerësimit periodik.

<i>Raporti i zbatimit të planit të veprimit me të dhënat në formë tabelare</i>				
Nr.	Aktivitetet e planifikuara	Drejtoria përgjegjëse	Niveli i realizimit	Veprimet e ndërmarra
1.	Trajnimi dhe aftësimi i grave në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatën Women4Women ka organizuar trajnime për gratë fushën e teknologjisë dhe komunikimit.
2.	Krijimi i programeve të partneritetit ndërmjet komunës dhe bizneseve lokale për të përkrahur krijimin e vendeve të punës.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Komuna e Lipjanit vazhdimisht është në kontakt me biznese dhe çdoherë kur kemi kërkesë nga këto për punëtorë, ne në bashkëpunim me entin social dërgojmë personat adekuat.
3.	Organizimi i dy panairove vendore në vitë me bizneset lokale.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Edhe gjatë vitit 2025 kemi pasur organizime të panairove, ku bizneset kanë pasur mundësi të ekspozojnë bizneset e tyre. Panairët janë mbajtur gjatë periudhës së verës.
4.	Hartimi dhe prezantimi i dokumenteve informative përpara komuniteteve përmes kampanjave, webfaqeve promovuese dhe eventeve.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Të gjitha dokumentet të cilat janë të nevojshme për departamentin për ekonomi dhe zhvillim janë hartuar dhe janë publikuar në webfaqe.

5.	Hartimi i planit rregullues për ZE në Qylagë.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	Në proces	Jemi në process për fillimin e hartimit të këtij plani.
6.	Hartimi i një plani për zhvillimin e Kodrës së Goleshtit si vend me potencial për aktivitete në fushën e aeronautikës si dhe implementimi i këtij plani.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Po kemi vit në bashkëpunim me organizatën Swiss Contact kemi hartuar masterplanin për zhvillimin e Kodrës së Goleshtit dhe njëkohësisht e kemi prezentuar në një konferencë për investitorë.
7.	Funksionalizimi i Zonës Ekonomike në Qylagë (sipas MOU-se me MINT).	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Zona Ekonomike në Qylagë tashmë është funksionalizuar, janë zgjedhur bizneset që do të operojnë aty, si dhe ka filluar puna për funksionalizimin e tyre.
8.	Zhvillimi i një oferte investuese "Doing Business in Lipjan" për tërheqjen e investimeve të huaja dhe vendore në zonat ekonomike Qylagë dhe zonat e tjera komerciale.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	Në proces	Jemi në proces të hartimit të një oferte të tillë për të gjithë investitorët e interesuar.
9.	Mbështetja e ndërmarrësisë tek grupet e marginalizuara me masa afirmative përmes subvencioneve dhe asistencës nga ekspertë.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Gjatë vitit 2025 janë ndarë 24 subveçione dhe grante për gra dhe të rinjë.
10.	Formalizimi dhe avancimi i bashkëpunimit të keshillit publiko-privat.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Keshilli Publiko Privat është funksionalizuar dhe gjatë vitit 2025 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar tema lidhur sfidat e bizneseve si

				dhe për forcimin e bashkëpunimit me sektorin publiko privat.
11.	Bashkëpunimi me DKA për identifikimin e sektorëve atraktivë dhe forcimin/krijimin e profileve profesionale në përputhje me kërkesat e tregut.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Bashkëpunimi me DKA-në ka vazhduar edhe në vitin 2025, lidhur me këtë temë, dhe përmes departamentit për zhvillim ekonomik vazhdimisht janë ofruar trajnime nga ana e bizneseve lidhur me profilet e kërkuara në tregun e punës.
12.	Zhvillim i programeve dhe trajnimeve me fokus ekonomikë qarkore dhe agjenden e gjelbert.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Në bashkëpunim me disa organizata joqeveritare kemi organizuar takime me tema të tilla.
13	Bashkëfinancimi i trajnimeve të certifikuara në hartim të projekt-propozimeve.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Në bashkëpunim me organizata të ndryshme kemi ofruar trajnime lidhur hartimin e projekt-propozimeve.
14.	Promovimi i produkteve nëpërmjet panairëve gjatë festave dhe hapjen e tregut mobil sezonal.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Përmes organizimit të panairëve që kemi mbajtur gjatë sezonës së verës, është bërë edhe promovimi i shumë produkteve nga ana e bizneseve.
15.	Përditesimi dhe promovimi i vazhdueshëm i portfolit ekonomik.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Kjo bëhet vazhdimisht nga e departamentit për ekonomi dhe zhvillim.
16.	Ndërtimi i qendrës urgjente në qytein e Lipjanit dhe QKMF.	Drejtoria e Shëndetësisë	E realizuar	Ndërtimi është në përfundim e sipër dhe pritet të përfundojë në këtë vit.

17.	Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF.	Drejtoria e Shëndetësisë	E realizuar	Ndërtimi është në përfundim e sipë pritet të përfundojë në këtë vit.
18.	Renovimi dhe adaptimi i QKMF-së ekzistuese për nevojat të OJQ-ve (të personave me aftësi të kufizuar) dhe Shogatave të tjera.	Drejtoria e Shëndetësisë	E realizuar	Ky projekt është i përfunduar dhe tashmë QKMF është e qasëshme për persona me aftësi të kufizuar dhe gjitha kategoritë e tjera.
19.	Bashkëfinancim i projekteve me Donatorë.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
20.	Asfaltimi i rrugicave në Magure, Vershevc, Leletiq, Poturovc, Torinë dhe Bujari Faza III.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
21.	Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi dhe Dobraj të Madhe Faza III.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
22.	Hapja dhe ndërtimi i rrugës Pjetër Bogdani deri të rruga Xhevdet Breznica, Lipjan.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
23.	Ndërtimi i trotuarit në fshatit Baic.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
24.	Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatrave Babush, Gadime faza IV.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.


25.	Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatrave Banull Gllavic, Marevc, Qallapek faza III.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
26.	Rregullimi i infrastrukturës në Oborin e Qendrës Rezedenciale.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
27.	Ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe Parkingut nëntokësor në Lipjan.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
28.	Rikonstruimi i ndriçimit publik në rrugën Sadik Shala, Ganimete Terbeshi, Isa Olluri, Afrim Zhiti në Lipjan.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
29.	Ndërtimi infrastrukturës së varrezave në fshatin Babush.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Ky projekt është përfunduar dhe tashmë realizuar plotësisht..
30.	Aneks të rrjetit të ujësjellësit në Lipjan, Sllovi.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Ky projekt është përfunduar dhe tashmë realizuar plotësisht.
31.	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimi i rrugicave në Kleqkë.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Ky projekt është përfunduar dhe tashmë realizuar plotësisht.

32.	Ndërtimi i Trotuarit Mareve – Llugaxhi	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Ky projekt është përfunduar dhe tashmë realizuar plotësisht.
33.	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kraishtë.	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Faza parë e parashikuar për vitin 2025 ka përfunduar.
34.	Organizimi i eventeve dhe aktiviteteve turistike për të tërhequr vizitorë, si festivale kulturore dhe ekskursione.	Drejtoria e Kulturës, Rimi dhe Sport	E realizuar	Gjatë periudhës verore janë organizuar aktivitete kulturore, rinore dhe sportive të ndryshme në vende turistike të komunës tone.
35.	Krijimi i qendrave për aktivitete në natyrë, siç janë kampet për paragjajding, ecje në natyrë dhe në zonat malore përreth.	Drejtoria e Kulturës, Rimi dhe Sport	E realizuar	Gjatë vitit 2025 janë organizuar aktivitetet të ndryshme në fushën e paragjajdit, dhe është mbajtur edhe festivali i paragjajdit në bashkëfinancim me organizatën SwissContact.
36.	Organizimi i festivaleve, panairove lokale ku artizanët mund të shesin dhe të ekspozojnë produktet e tyre.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	E realizuar	Gjatë vitit 2025 janë organizuar aktivitete kulturore, rinore dhe sportive (festivale), shkëmbime bashkëpunimi me shtetin fqinjë (Shqipërinë) në sektorin e kulturës.
37.	Funksionalizimi i Qendrës Turistike në Sheshin Adem Jashari në Qytetin e Lipjanit përmes digitalizimit në fushën e turizmit dhe shërbimeve tjera administrative.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	Në proces	Lidhur me këtë projekt ne jemi në process duke punuar dhe këtë vit do të finalizohet

38.	Bashkëfinancues në implementimin e planit për menaxhimin e qendrës historike të Janjevës me masat e përcaktuara dhe në bazë të mundësisë buxhetore.	Drejtoria e Kulturës, Rini dhe Sport	E realizuar	Komuna së bashku me UNDP vazhdimisht ka punuar funksionalizimin e qendrës historike të Janjevës. Njëkohësisht bashkë me institucionet qendrore kemi funksionalizuar një pjesë të qendres historike të Janjevës.
39.	Ndërtimi i Kullës Muze të veteraneve të UÇK-së Krojmit.	Drejtoria e Kulturës, Rini dhe Sport	E realizuar	Ky projekt ka filluar dhe tashmë është në fazën finale të përfundimit.
40.	Implementimi i aktiviteteve në kuadër të planit komunal të menaxhimit të mbeturinave 2024-2028	Drejtoria e Infrastrukturës	E realizuar	Gjatë vitit 2025 janë realizuar shumë aktivitete lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
41.	Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjetër në fushat sportive në Magurë dhe Dobraje e Madhe.	Drejtoria e Kulturës, Rini dhe Sport	E realizuar	Në fushat sportive në Dobraje të Madhe dhe Magurë, tashmë është vendosur bari sintetik dhe është rregulluar infrastruktura e nevojshme.

Data:20.01.2026

Kryesuese e Komisionit



Linda Shapini